

REFERENCË

Profesionalizimi dhe transparenca në partneritet me Dr. Falk Pharma

Ne punojmë me EwoPharma për mbi njëzet vite tashmë. Ajo që ka filluar me Salofalk® dhe Ursofalk® në disa shtete të përzgjedhura është rritur dhe zhvilluar në një bashkëpunim afatgjatë, kështuqë ne i besojmë EwoPharma me marketing, shitje dhe mbështetje rregullative, për një portfolio të gjërë të produkteve të Dr. Falk përgjatë Europës Lindore.

Rrjeti i gjërë dhe i mirë i EwoPharma's në regjion, na ka mundësuar të arrijmë shtrirjen e synuar. Si një partner i besueshëm, puna jonë me EwoPharma është karakterizuar gjithmonë me profesionalizëm dhe transparencë.

Ne e rekomandojmë EwoPharma te kompanitë tjera farmaceutike, të cilat kanë për qëllim shtrirjen në tregjet e Europës Lindore dhe Qendrore, si dhe i gëzohemi vazhdimit të partneritetit tonë të frytshëm në të ardhmen.

Ne në Dr. Falk Pharma, specializohemi në zhvillimin dhe shitjen e produkteve farmaceutike në fushën e gastroenterologjisë dhe hepatologjisë. Produktet tona, kryesisht Rx, shiten në 66 shtete, në të cilat ne shpesh bashkëpunojmë me partnerë lokalë si EwoPharma.

Duke filluar me një numër të vogël të produkteve të tregtuara në Poloni, Republikën Çeke, Slovaki, Bullgari dhe Rumani, portfolio e Dr. Falk në Europën Lindore Qendrore është rritur në mënyrë të vazhdueshme nga fillimi i partneritetit tonë në fund të viteve 1990-ta.

Këto tregje paraqesin një numër sfidash për kompani farmaceutike, duke përfshirë presionin e konkurrencës nga kompanitë tjera.

Jemi impresionuar me prezencën e gjërë të EwoPharma që ka ndërtuar në shumë shtete të regjionit, me një rrjet të madh të përfaqësuesve mjekësorë. Ata njihen mirë në tregje individuale dhe segmentet kyçe të tregut, që luan rol vendimtar në qasjen e suksesshme në regjionin e Europës Lindore Qendrore.

Ne i besojmë EwoPharma me marketing dhe shitje të produkteve tona në tregjet e Europës Lindore Qendrore përderisa ekspertiza e tyre dhe rrjeti i mjekëve dhe spitaleve kanë qenë jashtëzakonisht të suksesshme.

Në mes tjerash, EwoPharma ka ofruar mbështetje të vlefshme në këto tregje me qështje rregullative. Njohuritë e tyre të sistemit ligjor dhe proceseve të regjistrimit, janë treguar si shumë të vlefshme.

Ekipi i EwoPharma ka qenë gjithnjë shumë profesional në punën tonë të përbashkët, me specialistë me përvojë në selinë e tyre si dhe me specialistët lokal në tregje individuale.

Partneriteti jonë bazohet në besim – ne mund të mbështetemi në ta me një portfolio të gjërë të produkteve tona në këto tregje kyçe. Një faktor tjetër që karakterizon punën tonë me EwoPharma është transparenca dhe përgjegjshmëria e tyre, gjë që është shumë e vlefshme në industrinë tonë.

Ne i gëzohemi bashkëpunimit tonë me EwoPharma në të ardhmen me shumë optimizëm. Ata janë një partner i rëndësishëm i vazhdimit të biznesit.